

L I G J
Nr.8092, datë 21.3.1996

PËR SHËNDETIN MENDOR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Mbrojtja e shëndetit mendor sigurohet nga strukturat e administratës shtetërore dhe institucionet publike e private të caktuara për këtë qëllim. Shoqatat, fondacionet, organizatat bamirëse, organizmat e tjerë joqeveritarë, si dhe grupimet e pacientëve a familjarëve të tyre, ndihmojnë në mbrojtjen e shëndetit mendor.

Neni 2

Mbrojtja e shëndetit mendor realizohet nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të një mjedisi social të përshtatshëm për të sëmurët mendorë, si dhe nëpërmjet ndjekjes së një politike parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Neni 3

Politika parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor mbështetet në:

1. Zbatimin e parimeve të mbrojtjes së shëndetit mendor në institucionet arsimore, shëndetësore, qendrat e punës dhe repartet ushtarake.
2. Ngritjen e institucioneve parandaluese dhe këshilluese.
3. Mbështetjen e organizmave dhe iniciativave në fushën e kujdesit të shëndetit mendor.
4. Përfshirjen e elementeve të kujdesit shëndetësor mendor në programet e formimit për personat që punojnë në sektorët e arsimit, përkujdesjes shoqërore, shëndetësisë, administratës, organizimit të veprimtarive shlodhëse.
5. Realizimin e kërkimeve në fushën e përmirësimit të shëndetit mendor dhe parandalimin e çrregullimeve mendore.
6. Rikuperimin e shëndetit mendor të sëmurët.

Neni 4

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Person me çrregullime mendore” është personi që:
 - a) paraqet probleme të funksionimit mendor, të cilat, në bazë të njohurive mjekësore, klasifikohen si çrregullime mendore dhe është nevoja për trajtim të specializuar shëndetësor;
 - b) ka prapambetje mendore;
 - c) paraqet çrregullime psikosociale, që kërkojnë trajtim të specializuar psikosocial;
2. “Institucion psikiatrik dhe rehabilitues” janë:
 - a) spitali psikiatrik;
 - b) reparti psikiatrik në një spital të përgjithshëm;
 - c) shtëpitë e kurimit dhe/ose rehabilitimit;

d) agjencitë e shërbimeve sociale.

3. “Institucionet për personat me prapambetje mendore” janë institucionet e rehabilitimit, edukimit dhe të kujdesjes për personat me prapambetje mendore.

4. “Miratimi” është pranimi i bërë me vullnet të lirë nga personi me çrregullime mendore, i cili është në gjendje të kuptojë informacionin e transmetuar në mënyrë të qartë e të kuptueshme, lidhur me shtrimin në një institucion psikiatrik, procedurat e diagnostikimit dhe trajtimit, si dhe rezultatet që priten prej tyre.

Neni 5

Kujdesi për shëndetin mendor për personat me çrregullime mendore sigurohet nga shërbimi i kujdesit psikosocial, shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor nëpërmjet mjekut të familjes dhe në veçanti nga shërbimi shëndetësor psikiatrik, i cili përfshin trajtimin e urgjencës, shërbimin ambulator, kujdesin spitalor, shtëpitë e kurimit, kujdesin komunitar, shërbimin psikosocial nëpërmjet psikologut dhe punonjësit social.

Neni 6

Personat me zhvillim mendor të vonuar dhe ata me çrregullime mendore trajtohen falas në institucionet publike të kurimit, rehabilitimit, arsimimit dhe edukimit.

Kur këta persona janë nën moshën 18 vjeç dhe trajtohen në institucione private, shteti mbulon pjesën e shpenzimeve të barabartë me koston e trajtimit në institucionet publike.

Neni 7

Organizmat e përkujdesjes shoqërore, në bashkëpunim me shërbimin shëndetësor psikiatrik e psikosocial, sigurojnë mbështetjen sociale për personat, të cilët, për shkak të sëmundjeve mendore ose zhvillimit mendor të vonuar, kanë vështirësi në sigurimin e një jete normale, nëpërmjet:

1. ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive për të siguruar jetesën;
2. organizimin e ndihmës nga persona, grupe, organizma dhe institucione vullnetare;
3. sigurimin e mbështetjes financiare dhe materiale, në përputhje me parimet e politikës shëndetësore dhe të përkrahjes sociale.

Neni 8

Në të gjitha institucionet psikiatrike dhe rehabilituese, Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë cakton punonjës socialë, të cilët mbikëqyrin trajtimin e pacientëve nga pikëpamja sociale dhe e mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Neni 9

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë përcakton parimet bazë të politikës rehabilituese dhe edukative për fëmijët dhe të rinjtë me shkallë të ndryshme prapambetjeje mendore.

KREU II

EKZAMINIMI, TRAJTIMI, REHABILITIMI, KUJDESI DHE ASISTENCA

Neni 10

Mjeku i familjes ka të drejtë të lëshojë një certifikatë mjekësore ose të rekomandojë një person me çrregullime mendore te mjeku psikiatër, psikologu a punonjësi social, si dhe të rekomandojë trajtimin në një institucion të kujdesit shëndetësor, vetëm pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të atij personi. Rekomandimi për një institucion psikiatrik lëshohet ditën e ekzaminimit dhe është i vlefshëm

për një periudhë 5-ditore.

Punonjësi social a psikologu, kur e gjykojnë të arsyeshme, rekomandojnë personin me çrregullime mendore te mjeku i familjes ose mjeku psikiatër.

Neni 11

Trajtimi në institucionet psikiatrike e rehabilituese rregullohet në bazë të parimeve të përgjithshme të politikës shëndetësore e sociale. Ky trajtim është i njëjtë me atë që u sigurohet të sëmurëve në spitalet e përgjithshme. Në këtë trajtim duhet marrë parasysh jo vetëm aspekti mjekësor, por edhe interesat dhe vlerat e tjera personale të personit që trajtohet, duke synuar përmirësimin e shëndetit të tij mendor me sa më pak shqetësim për të.

Neni 12

Personi me çrregullime mendore i shtruar në një institucion psikiatrik e rehabilitues ka të drejtën e kontakteve të pakufizuara me familjen dhe persona të tjerë.

Kontaktet mund të kufizohen, për aq kohë sa është e nevojshme, kur ato ndikojnë negativisht në gjendjen shëndetësore të personit, me vendim të mjekut kurues dhe miratim të drejtësisë të institucionit. Korrespondenca e tij nuk kontrollohet.

Neni 13

Personi me çrregullime mendore që është duke u trajtuar në një institucion psikiatrik e rehabilitues, me propozim të mjekut që e trajton dhe miratim të titullarit të institucionit, mund të lejohet të largohet përkohësisht nga institucioni, pa u konsideruar i dalë prej andej, me kusht që të mos paraqesë rrezik për shëndetin dhe jetën e tij ose të të tjerëve.

Neni 14

Veprimtaria rehabilituese në institucionet psikiatrike e rehabilituese nuk ka qëllim fitimi. Përfshirja e të sëmurëve me çrregullime mendore në veprimtari punësuese brenda institucionit psikiatrik ka karakter vullnetar, mjekues dhe rehabilitues, si dhe lehtëson riintegrimin e pacientëve në jetën shoqërore. Kushtet e punës, mjediset dhe problemet e tjera që kanë të bëjnë me politikën rehabilituese në institucionet psikiatrike, përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

Neni 15

Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore ose me prapambetje mendore mund të propozohet nga komisioni psikiatriko-ligjor, i përbërë nga jo më pak se 3 veta. Vendimi përkatës merret nga gjykata në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Në vendim gjykata cakton edhe kujdestarin ligjor të tij.

Neni 16

Titullari i institucionit psikiatrik e rehabilitues duhet të njoftojë gjykatën e rrethit, nëse vërtetohet që kujdestari ligjor i personit me çrregullime mendore ose me prapambetje mendore, që ndodhet nën kontrollin e institucionit të tij, nuk i përmbush detyrimet e tij. Në këtë rast gjykata mund të revokojë kujdestarin e caktuar më parë, duke caktuar një kujdestar të ri.

Neni 17

Personi i sëmurë, kujdestari i tij ligjor dhe familjarët e tij gëzojnë të drejtën për t'u informuar për gjendjen shëndetësore të tij si dhe metodat e ekzaminimit e të kurimit që do të zbatohen.

Informacioni jepet nga mjeku kurues ose punonjësi social, në bazë të gjendjes shëndetësore të

pacientit dhe të parimeve të etikës mjekësore.

Neni 18

Dispozitat e këtij ligji, që parashikojnë të drejtën e personit me çrregullime mendore për të pranuar shtrimin, diagnostikimin, trajtimin dhe daljen nga institucioni psikiatrik, janë të vlefshme edhe për kujdestarin ligjor të pacientit të mitur dhe/ose të atij që i është hequr a kufizuar zotësia për të vepruar.

KREU III KUFIZIMI FIZIK

Neni 19

Kufizimi fizik i personit me çrregullime mendore parashikon mbajtjen me forcë, përdorimin e detyruar të medikamenteve, imobilizimin ose izolimin. Kushtet dhe mënyra e aplikimit të tyre përcaktohen në rregulloren e shërbimit psikiatrik.

Neni 20

Për realizimin e detyrimeve të këtij ligji, kufizimi fizik i personave me çrregullime mendore mund të përdoret vetëm kur:

- a) personi paraqet rrezikshmëri për shëndetin dhe/ose jetën e tij dhe të të tjerëve;
- b) kryen veprime kundër sigurisë publike;
- c) me veprimet e tij dëmton ose shkatërron objektet përreth;
- d) si dhe në të gjitha ato raste që parashikohen në rregulloren e shërbimit psikiatrik.

Neni 21

Vendimi për të zbatuar kufizimin fizik merret nga mjeku, i cili përcakton mënyrën e kufizimit dhe mbikëqyr personalisht zbatimin e saj. Në institucionet psikiatrike e rehabilituese, kur është i pamundur siguri i vendimit të menjëhershëm të mjekut, vendimi për zbatimin e kufizimit fizik jepet nga infermieri, i cili njofton menjëherë mjekun. Mjeku mund të shfuqizojë vendimin e infermierit, kur e gjen të padrejtë.

Veprimet e mjekut, si dhe vendimet e marra nga ai pasqyrohen në dokumentacionin përkatës.

Neni 22

Përpara zbatimit të kufizimit fizik, personi që do të kufizohet duhet të informohet. Gjatë zbatimit të kufizimit fizik duhet të zgjidhet mënyra më pak shqetësuese dhe të tregohet kujdes për mirëqenien e personit.

Neni 23

Vendimi i kufizimit fizik duhet të përligjet brenda 24 orëve nga marrja e tij përpara një komisioni të përherëshëm të ngritur për këtë qëllim pranë institucionit psikiatrik e rehabilitues.

Përbërja e komisionit, të drejtat dhe detyrat, si dhe mënyra e funksionimit të tij, përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 24

Për zbatimin e vendimeve të kufizimit fizik, për rastet e parashkuara në nenin 19, shërbimi i urgjencës, policia dhe zjarrfikësit janë të detyruar të ndihmojnë mjekun me kërkesën e tij.

KREU IV SHTRIMI, TRAJTIMI DHE DALJA NË INSTITUCIONIN PSIKIATRIK

Neni 25

Personi, i cili për shkak të çrregullimeve mendore:

1. paraqet rrezikshmëri për jetën ose shëndetin e tij dhe/ose të tjerëve;
2. është i paaftë të përmbushë nevojat e tij jetësore, mund të bëhet objekt i një ekzaminimi psikiatrik pa pëlqimin e tij, ose të përfaqësuesit ligjor. Ekzaminimi i detyrueshëm bëhet me vendim të mjekut specialist. Mjeku psikiatër, nëse e sheh të nevojshme, mund të urdhërojë transferimin e menjëhershëm të të ekzaminuarit në spital. Në rastet kur është zbatuar masa e kufizimit fizik, personi duhet të transferohet në spital i shoqëruar nga mjeku specialist dhe personat e ngarkuar me këtë detyrë. Mjeku që kryen ekzaminimin fizik në kushtet e përmendura në këtë nen, duhet ta regjistrojë këtë fakt në dokumente mjekësore (kartelë), duke shpjeguar shkaqet e zbatimit së kësaj mase.

Neni 26

Personi me çrregullime mendore shtrohet në një institucion psikiatrik pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, nëse këtë e ka kërkuar mjeku i autorizuar në vijim të ekzaminimit të drejtpërdrejtë të personit dhe kur përmbushen kriteret e indikacionet e përcaktuara për shtrim në spital.

Shtrimi në një spital psikiatrik i të miturve ose personave të papërgjegjshëm bëhet me miratim me shkrim të kujdestarit ligjor të personit. Nëse ka mosmarrëveshje ndërmjet deklaratave për shtrimin në spital të bëra nga personi i mitur në moshë 12-18 vjeç dhe kujdestari ligjor i tij, vendimi për shtrimin në spital merret nga komisioni i mjekëve.

Neni 27

Një person me çrregullime mendore mund të shtrohet në një institucion psikiatrik, pa marrë miratimin e cituar në nenin 26, vetëm nëse për shkak të çrregullimit mendor të tij ai paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën ose shëndetin e tij dhe të të tjerëve.

Vendimi për shtrimin e një personi merret nga mjeku specialist vetëm pasi të ketë kryer personalisht ekzaminimin e tij.

Personi i sëmurë, familjarët e tij ose kujdestari ligjor gëzojnë të drejtën të informohen për shkaqet e marrjes së këtij vendimi.

Procedurat e shtrimit pasqyrohen në kartelat klinike.

Neni 28

Mjeku që vendos shtrimin pa miratimin e personit, kujdestarit ligjor të tij, duhet të njoftojë brenda 24 orëve shefin e klinikës, i cili lejon ose jo mbajtjen e mëtejshme të personit në institucionin psikiatrik.

Shefi i klinikës, brenda 48 orëve nga dhënia e lejes për shtrim të detyruar, duhet ta paraqesë rastin përpara gjykatësit të vetëm në gjykatën e rrethit ku ndodhet insitucioni.

Neni 29

Gjyqtari i vetëm, i cili shqyrton çështjen jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e saj, thërret për shpjegime personin e shtruar në institucionin pa miratimin e tij, kujdestarin ligjor të tij, mjekun që ka kryer shtrimin, shefin e klinikës që e ka lejuar, si dhe familjarët ose personat e interesuar për të shtruarin. Vendimi i gjyqtarit të vetëm për ta mbajtur ose për ta nxjerrë të sëmurin nga institucioni psikiatrik zbatohet menjëherë.

Neni 30

Në rast se personi i shtruar pa miratimin e tij në institucionin psikiatrik e jep miratimin pas

shtrimit dhe shefi i klinikës bindet se miratimi është dhënë pas informimit të rregullt, dërgimi i çështjes në gjykatë nuk bëhet.

Neni 31

Personi i shtruar në një institucion psikiatrik dhe kujdestari ligjor i tij kanë të drejtën e informimit të plotë për trajtimin terapeutik që propozon mjeku specialist. Informimi përmbledh mënyrën e trajtimit, medikamentet që do të përdoren dhe efektet anësore të mundshme, rezultatet që priten prej trajtimit, kohëzgjatjen, trajtimet alternative, si dhe të dhëna të tjera që kërkohen prej tyre.

Neni 32

Personi i shtruar pa miratimin e tij në një institucion psikiatrik trajtohet me procedurat mjekësore të domosdoshme, për të shmangur çrregullimet që kanë sjellë në shtrimin pa miratim të tij.

Neni 33

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton me rregullore të veçantë mënyrat dhe procedurat e trajtimit terapeutik që janë më të rrezikshme për shëndetin e pacientit dhe për të cilat kërkohet me çdo kusht miratimi i tij ose i kujdestarit ligjor.

Neni 34

Kufizimi fizik mund të zbatohet ndaj një personi të shtruar në institucionin psikiatrik pa miratimin e tij në rrethanat e përcaktuara në nenin 20 të ligjit, si dhe kur ky kufizim është i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet terapeutike të domosdoshme. Kufizimi mund të zbatohet edhe për të penguar largimin pa leje nga institucioni psikiatrik.

Neni 35

Vendimi për nxjerrjen nga institucioni psikiatrik i një personi të shtruar me miratimin e tij merret nga shefi i pavionit dhe nga mjeku kurues, në rastet kur personi nuk paraqet më rrezikshmëri për veten e tij dhe për të tjerët. Zgjatja e periudhës së shtrimit bëhet me vendim të mjekut specialist. Për vendimin e mësipërm shefi i pavionit vë në dijeni familjen, kujdestarin ligjor ose personat e interesuar.

Neni 36

Për çdo person të shtruar me ose pa miratimin e tij në një institucion psikiatrik, familja e tij ose përfaqësuesi ligjor kanë të drejtën të kërkojnë daljen nga spitali në çdo kohë.

Kjo kërkesë mund të bëhet në çdo formë dhe regjistrohet në kartelën klinike personale.

Nëse refuzohet dalja nga spitali, ata kanë të drejtën të ankohen në gjykatën e rrethit ku ndodhet institucioni psikiatrik, brenda 7 ditësh nga dita e marrjes dijeni, dhe çështja shqyrtohet nga gjyqari i vetëm, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 37

Personi që për shkak të prapambetjes mendore:

- a) nuk është i aftë të kujdeset për veten dhe të përmbushë nevojat jetësore të tij,
- b) nuk ka të siguruar kujdesin e personave të tjerë dhe
- c) nuk ka nevojë për trajtim psikiatrik,

rekomandohet nga mjeku për pranim në institucionet për personat me prapambetje mendore.

Neni 38

Për personat e pranuar në këto institucione pa miratimin e tyre ose të kujdestarit ligjor zbatohen dispozitat e këtij kreu.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 39

Personat që zhvillojnë veprimtari të parashikuara në këtë ligj janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional për çështje që i kanë mësuar gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Këta persona përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së sekretit profesional vetëm kur informacioni i jepet mjekut kurues të të sëmurit dhe/ose organizmave të asistencës sociale, si dhe organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion.

Neni 40

Personat e përmendur në nenin 39 nuk mund të paraqiten në gjyq me cilësinë e dëshmitarit në një proces ndaj një personi me çrregullime mendore të trajtuar prej tyre, përveçse kur me ligj parashikohet ndryshe.

Neni 41

Personat me çrregullime mendore që kanë kryer një vepër penale dhe janë dënuar nga gjykata të vuajnë dënimin në institucione psikiatrike, përfitojnë kujdesin mjekësor sipas dispozitave të këtij ligji.

Për ta nuk zbatohen dispozitat e parashikuara në nenet 12, 13, 26, 34 dhe 35 të këtij ligji.

Neni 42

Masat e sigurimit për personat e përmendur në nenin 41 merren nga organet e ngarkuara për ruajtjen e tyre, sipas rregullores së miratuar nga ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 43

Institucionet psikiatrike janë të detyruara të shqyrtojnë të gjitha kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga shoqata a grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarëve ose personave të interesuar për mbrojtjen e interesave të të sëmurëve mendorë.

Neni 44

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë miratojnë rregulloret e nevojshme për zbatimin e këtij ligji, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha institucionet psikiatrike publike dhe private.

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1447, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha